REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**

**PROJEKT VENDIM**

**Date 06.03.2025**

## PËR MIRATIMIN E DISA TRANSFERIME NË ZËRIN INVESTIME NGA TE ARDHURAT E BASHKISE, NË BUXHETIN E VITIT 2025 ,MIRATUAR ME VKB NR. 68, DATË 20.12.2024

Grupi Menaxhimit Stategjik në mbështetje, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH", neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me ligjin nr.57/2016 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9936, dt.26.06.2008", i ndryshuar, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetitn e vitit 2025",Udhezimit Nr.9, date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit, Udhezimit Nr.2, date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025",

## PROPOZON

**1–** Transferim buxheti sipas tabeles me poshteme:

| NR | PERIUDHA | ENTITET | M.LINJES | INSTITUCION | KAPITULL | OBJEKTI SHPENZIMIT | PROGRAM | ARTIKULL | SUBACCAUNT | IDO | PROJEKT | B.TIP | SPARE 1 | SPARE 2 | DEBI (SHTESE) | KREDI (PAKESIME) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 03-2025 | 139 | 00 | 2139001 | 05 | INVESTIME NE SEGMENTET RRUGORE TE BASHKISE SKRAPAR | 04520 | 2310000 | 00000 | 0232 | 1390381 | 00 | 0 | 0 | | 14,501,521 |
| 2 | 03-2025 | 139 | 00 | 2139001 | 05 | MUR MBAJTES PERGJAT LUMIT OSUM, TE ISH KANTIERI NSHN-së, FAZA II | 04240 | 2310000 | 00000 | 0232 | +++++++ | 00 | 0 | 0 | 12,831,224 | |
| 3 | 03-2025 | 139 | 00 | 2139001 | 05 | MBIKQYRJE PUNIMESH NE OBJEKTIN MUR MBAJTES PERGJAT LUMIT OSUM, TE ISH KANTIERI NSHN-së, FAZA II | 04240 | 2310000 | 00000 | 0232 | +++++++ | 00 | 0 | 0 | 1,452,432 | |
| 4 | 03-2025 | 139 | 00 | 2139001 | 05 | KOLAUDIM PUNIMESH NE OBJEKTIN MUR MBAJTES PERGJAT LUMIT OSUM, TE ISH KANTIERI NSHN-së, FAZA II | 04240 | 2310000 | 00000 | 0232 | +++++++ | 00 | 0 | 0 | 217,865 | |
| | | | | | | TOTALI | | | | | | | | | 14,501,521 | 14,501,521 |

Grupi Menaxhimit Stategjik

1- Adriatik Mema Kryetar GMS (Kryetar i Bashkisë)

2- Xhanina Llango Kordinator GMS (N/Kryetare Bashkisë)

3- Altin Lamçe Anetar i GMS (N/Kryetar i Bashkise)

4- Rudina Llango Kordinatore Riskut (Dr. Shërbimeve Ligjore dhe Prokurimeve)

5- Teuta Sheshi Zyrtari Pergjegjes per Buxhetin (Përgjegjëse Sekt. Finances)

6- Habibe Breshani Zyrtari Pergjegjes per te Ardhurat (Drejtore Tatim-Taksave)

7- Andia Kadiu Vezhguese ( Pergjegjese Sektorit Arsim, Sport ,Kulture)

Naim Gogo Sekretar i GMS (Drejtori Finacës dhe Buxhetit)

KRYETARI
ADRIATIK MEMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SKRAPAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA SKRAPAR

## RELACION

## PËR MIRATIMIN E DISA TRANSFERIME NË ZËRIN INVESTIME NGA TE ARDHURAT E BASHKISE, NË BUXHETIN E VITIT 2025 ,MIRATUAR ME VKB NR. 68, DATË 20.12.2024

Të nderuar Këshilltar!

Grupi Menaxhimit Stategjik në mbështetje, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH", neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me ligjin nr.57/2016 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9936, dt.26.06.2008", i ndryshuar, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetitn e vitit 2025",Udhezimit Nr.9, date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit, Udhezimit Nr.2, date 24.01.2025 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025, propozon per miratim disa transferime ne Buxhetin e vitit 2025 te Bashkise Skrapar dhe Institucioneve ne varesi te saj ne zerin Investime.

Ndryshimet konsistojnë në pakesimin e fondit te investimet me objekte: **"Investime ne segmentet rrugore te Bashkise Skrapar"**, ne vleren prej 14,501,521 leke dhe kjo vlere te shtohet perkatesishte ne objektet e investimeve si me poshte:

1-"**Mur mbajtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri i N.SH.N", Faza e dytë"** ne vleren prej 12,831,224 leke, si pjese e vleres se bashkfinancimit ne nivelin 20% te vleres projektit.
2-"**Mbikqyrje punimesh ne objektin: Mur mbajtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri i N.SH.N, Faza e dytë"**, ne vleren prej 1,452,432 leke.
3-"**Kolaudim punimesh ne objektin: Mur mbajtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri i N.SH.N, Faza e dytë",** ne vleren prej 217,865 leke.

Per ndryshimet e mesiperme ju sqarojme se:

Bashkia Skrapar, gjatë vitit 2024, ka aplikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me shkresë nr.3724 datë 31.10.2024, lidhur me objektin ***"Mur mbajtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri i N.SH.N", Faza e dytë Loti 1".***
Sipas formularit të aplikimit, Bashkia Skrapar kërkoi nga AKMC, financimin e vlerës së punime në shumën **64,156,120.74 lekë me tvsh,** ndërsa vlera e mbiqyrjes së punimeve dhe kolaudimit do të mbulohet nga Bashkia Skrapar. *(bashkëlidhur formulari i aplikimit).*
Në fillim të vitit 2025, gjatë shqyrtimit të kërkesave për financim projektesh, të aplikuara nga bashkitë, ashtu si dhe Bashkia Skrapar, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kërkoi që bashkitë të mernin përsipër financimin e 20% të vlerës së projektit, si nje kriter favorizues per fitimin e projektit.

Me shkresë nr. 422 prot. datë 04.02.2025 të Bashkisë Skrapar, me subjekt: Deklarim per bashkfinancim projekti, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Bashkia Skrapar mori përsipër finacimin e 20% të vlerës së projektit. *(shkresa bashkëlidhur).*

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.127 datë 28.02.2025, protokolluar në Bashkinë Skrapar me nr.824 prot. datë 04.03.2025, *"Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të Vetqeverisje vendore"*, është miratuar lista e projekteve fituese, ndërmjet të cilëve dhe projekti i Bashkisë Skrapar, me objekt ***"Mur mbajtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri i N.SH.N", Faza e dytë"*** në vlerën prej **51,324,897 lekë.**

Vlera që duhet të përballohet nga fondet e Bashkisë Skrapar për këtë projekt është **12,831,224 lekë** e cila përbën 20% të vlerës totale të projektit prej **64,156,120.74** lekë.

Gjithashtu Bashkia Skrapar duhet të financojë edhe vlerën e mbikqyrjes së punimeve dhe atë të kolaudimit të punimeve në shumën:

- Mbikqyrje punimesh **1,452,432** lekë
- Kolaudim punimesh **217,865** lekë

Ju faleminderit

**KRYETARI**
**ADRIATIK MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SKRAPAR